U D H Ë Z I M
Nr.5 datë 3.9.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE NR.1, DATË 11.7.2003 "MBI PROCEDURAT E RISHIKIMIT TË LISTAVE PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE 2003", NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN NR.2, DATË 25.7.2003

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2003, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Dodë Prenga	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Igli Toska	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar

në mbështetje të nenit 29/1,6, nenit 31/1, nenit 44/2 dhe nenit 58 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

U D H Ë Z O N:

Në udhëzimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.1, datë 11.7.2003 "Mbi procedurat e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2003", ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 25.7.2003, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 6, në pjesën III.dh) "Zgjedhësi është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit", paragrafi 2/ii bëhet:

ii. Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesaur:

- kërkesë me shkrim ku të jetë/në shënuar zgjedhësi/sit që pretendohet se nuk është/janë në qendrën e duhur të votimit dhe qendra e votimit ku pretendohet të jetë/në.

Në rast se nuk ka kërkesë personale të zgjedhësit për të ndryshuar qendrën e votimit, KZQV-ja, i dërgon zyrës së gjendjes civile përkatëse të dhënat e zgjedhësit/ve për të përcaktuar vendbanimin e zgjedhësit/ve.

2. Në pikën 6, në pjesën III.e) "Zgjedhësi nuk është në listën paraprake të qendrës së votimit të vendbanimit të tij", paragrafi i/3 bëhet:

"Në rastin kur zgjedhësi paraqet për dokument indentifikimi letërnjoftimin, pasaportën ose kartën e zgjedhësit, ai duhet të paraqesë një certifikatë personale të lëshuar nga zyra e gjendjes civile të njësisë përkatëse, jo më vonë se tre muaj nga data e paraqitjes së saj.".

3. Në pikën 6, në pjesën III.e) "Zgjedhësi nuk është në listën paraprake të qendrës së votimit të vendbanimit të tij", pika "3. Shqyrtimi i kërkesës dhe marrja e vendimit", paragrafi ii/1 bëhet:

"Në rast se grupi i verifikimit gjen zgjedhësin, ai duhet t'i marrë atij një deklaratë, nëse dëshiron të votojë në qendrën përkatëse të votimit të njësisë zgjedhore. Deklarata është sipas modelit të miratuar nga KQZ dhe kundërfirmohet dhe nga anëtarët e grupit të verifikimit.

- Nëse zgjedhësi deklaron se nuk dëshiron të votojë në këtë njësi, KZQV-ja përkatëse merr vendim për rrëzimin e kërkesës.

- Nëse zgjedhësi deklaron se dëshiron të votojë në qendrën përkatëse të votimit të njësisë zgjedhore, KZQV-ja merr vendim sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin I pika (iii) të udhëzimit të KQZ-së nr.1, datë 11.7.2003.".

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.